

Jona Leqejza



Jona Leqejza është diplomuar në Vjenë dhe mban titullin Master Shkencor në Administrim Biznes dhe Master Shkencor në fushën menaxhim me fokus marketing. Mban titullin Kontabël i Miratuar që nga viti 2014. Diplomohet nga Akademia Studimeve politike në 2023 pas përfundimit me sukses të programit dhe prezantimit të punimit shkencor final. Kandidate për titull ACCA- Association of Chartered Certified Accountants në Glasgow, Mbretëri e Bashkuar.

Anëtare themeluese dhe vullnetare aktive e shoqatës Animals Need Me, një shoqatë shumë aktive në lobing për të drejtat e kafshëve dhe realizuese e më shumë se 3,000 sterilizimeve falas në Bashkinë Shkodër dhe menaxhuese e strehës së pare private në rajon për qen të sëmurë e të paaftë. Anëtare themeluese dhe drejtuese e Qendra për Zhvillim dhe

Neurorehabilitim Ida Hoxha, aktive në fushën e lobingut për politikën e duhura socio-sanitare për fëmijët e patologjive neurologjike dhe sindromave të rralla.

Jona ka punuar në sektorin e auditimit dhe konsulencës financiare në dy nga Big Four të fushës, Deloitte Albania dhe Ernst and Young për 5 vite. Pas vitit 2014 është angazhuar në sektorin e industrisë dhe prodhimit tekstil ku mbulon fushën e inovacionit të produkteve dhe teknologjisë. Gjatë eksperiencës së saj në këtë sektor ka ndërtuar 4 linja tregtare me cikël të plotë “made in albania” dhe ka asistuar në ndërtimin dhe implementimin e një moduli për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe një sistem ERP (enterprise resource planning). Në vitin 2022, angazhohet nëpërmjet SASPAC si drejtuese e sekretariatit teknik të programit të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri Kosovë.

Jona Leqejza ka filluar mandatin e saj të parë në Këshillin e Bashkisë Shkodër në gusht të vitit 2019 ku ka drejtuar komisionin e kontrollit financiar nga ku ka marrë edhe angazhim për të kryer raportime kontrolli të posaçme të kërkuara nga Asambleja e Përgjithshme e K.F Vllaznia në lidhje me shëndetin financiar të shoqërisë dhe sugjerimet për përgatitje për privatizim i cili u realizua në nëntor 2020 dhe konsiderohet si një ndër arritjet kryesore të kësaj legjislature. Ndërsa në funksionin e saj si sekretare e Komisionit të Buxhetit, Financave, dhe Aseteve Publike ka prezantuar në konkurs kombëtar të AMVV për Praktikën më të Mirë, modelin e buxhetimit me pjesëmarrje ndërmarrë rishtazi nga Këshilli Bashkiak Shkodër, ku është shpallur edhe rast fitues në kategorinë përkatëse dhe ka koordinuar përgjatë gjithë viteve të aktivitetit mbledhjet e komisioneve ndërsa ka përgatitur propozimet e Këshillit Bashkiak ndaj ekzekutivit për modifikim dhe përmirësim të dokumentit të buxhetit.

Si këshilltare ka ndërmarrë nisma të shumta si: rezolutë për lehtësi fiskale në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të Covid 19; nisëm për buxhetimin e fondeve shtesë për të siguruar mësuere mbështetëse në kopshte dhe çerdhe, nxitëse ndaj bashkisë për krijimin e një plani efektiv të përmirësimit të shërbimit në kopshte dhe çerdhe, nismëtare për ndryshimin në paketë fiskale për të

subvencionuar tarifën e kopshteve dhe çerdheve për fëmijët me aftësi ndryshe, organizatore e tryezës së parë të përbashkët mes aktorëve të sistemit parashkollor, sistemit shëndetësor parësor, urdhrit të psikologut, dhe shërbimit të shëndetit mendor për të harmonizuar politikat dhe protokollin në identifikim dhe mirëmbajtjen e fëmijëve me aftësi ndryshe.

Jona ka kandiduar në zgjedhje parlamentare 2021 në radhët e Partisë Socialiste, ndërsa në zgjedhjet e vitit 2023 është rikonfirmuar si këshilltare, po në këtë forcë politike. Sot mban pozicionin e anëtares së asamblesë së partisë socialiste për Bashkinë Shkodër në cilësinë e këshilltares por nuk mban funksione të veçanta në këtë strukturë politike.